

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtaren e vetme gjykuese Fatime Dermaku, me zyrtaren ligjore Edona Grajçevci, procesmbajtëse, në çështjen penale, kundër të pandehurit A.D., për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.3202/13, të datës 23.06.2014, të cilën e përfaqësonte prokurori i Shtetit Enver Krasniqi, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 07.05.2018, mori dhe publikisht shpalli në njëjtën ditë, ndërsa me datë 22.05.2018, e përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri: A.D., nga i ati Xh. dhe nëna M., e vajzërisë B., i lindur me ..., në fshatin L., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i pa punësuar, me nr. personal ..., i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse: me datë 08.05.2018, në rrugën “G.Z.”, në P., pikërisht në Klinikën A., me qellim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme, vetit t’i sjellë përfitime pasurore në mënyrë të kundërligjshme, ka marrë pasurinë e të dëmtuarës A.S., në atë mënyrë e cila kishte lenë çantën e saj në vendin e punës, në zyrën e pranimit në Klinikën A., i pandehuri e ka shfrytëzuar rastin derisa e dëmtuara nuk ishte në zyre dhe ja ka vjedhur kuletën të cilën e kishte në çantë së bashku me 60 €, dhe dokumente personale, me ç’rast të njëjtës i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 80 €,

- me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPRK-së

Andaj, gjyqtarja e vetme gjykuese, në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 45, 46, 51,52, 73,74,75 dhe 76 të KPRK, si dhe nenit 248 dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit , A.D. i shqipton :

GJYKIM ME KUSHT-ME BURGIM DHE DËNIM ME GJOBË

- Ashtu që të pandehurit A.D., i caktohet dënimi me burg kohëzgjatje prej 1 (një) viti, dhe dënim me gjobë në shumën prej 100€, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbajë/paguaj, nëse në afat prej 2(dy) viteve, nga dita kur aktgjykimi merr formë të prerë nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.
- Nëse revokohet dënimi me gjobë dhe i pandehuri nuk mundet apo nuk do t’a përmbush atëherë dënimi me gjobë do t’i zëvendësohet me dënim me burgim edhe atë për 20 €, të dënimit me gjobë do të vuaj një ditë burg.

- E dëmtuara: A.S., me vendbanim në rrugën “I.K.”, në P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil
- Detyrohet i pandehuri që t’i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

ARSYETIMI

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.3202/13, të datës 23.06.2014 të, ndaj të pandehurit A.D., për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPRK-së

Pas pranimit të aktakuzës, gjyqtarja e vetme gjykuese, e ka caktuar shqyrtimin gjyqësor, për datën 07.05.2018, ku është lexuar aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtarja e vetme gjykuese pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjyqtarja e vetme gjykuese, ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtarja e vetme gjykuese e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- se i pandehuri A.D. nga e ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPRK-së, si në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 325 par. 1 të KPRK-së është paraparë forma themelore e kësaj vepre penale, sipas së cilës dispozitë është përcaktuar: “ Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumë prej pesëdhjetë (50) Euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet”.

5. Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjyqtarja e vetme gjykuese, ka vendosur që të pandehurit A.D. t'a shpall fajtor për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së lartcekur, meqenëse u vërtetua se i njëjti e ka kryer veprën penale siç edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtën është penalisht përgjegjës.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Duke u bazuar në nenin 73 dhe 74 të KPRK, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurës, gjyqtarja e vetme gjykuese, i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese për të pandehurin, gjyqtarja e vetme gjykuese, i ka marrë për bazë sjelljet e mira të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor; pranimin e fajësisë; si dhe faktin se sipas deklaratës së të pandehurit, të cilës gjyqtarja e vetme gjykuese, ia fali besimin, është i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punësuar, i njëjti është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale dhe se ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale. Gjithashtu, me rastin e shqiptimit të dënimit me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, dhe dënim me gjobë në shumën prej 100€, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbajë/paguaj, nëse në afat prej 2(dy) viteve, nga dita kur aktgjykimi merr formë të prerë nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, gjyqtarja e vetme gjykuese e ka marrë për bazë edhe gjendjen pasurore të pandehurit dhe të ardhurat e tij, meqenëse siç e theksuam më lartë është i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa, gjyqtarja e vetme gjykuese, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese në këtë çështje penale.

7. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarës së vetme gjykuese, i caktohet dënimi me burg kohëzgjatje prej 1 (një) viti, dhe dënim me gjobë në shumën prej 100€, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbajë/paguaj, nëse në afat prej 2(dy) viteve, nga dita kur aktgjykimi merr formë të prerë nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, ndaj të pandehurit A.D., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendurit më lart, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e saj; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8. Udhëzimi i të dëmtuarës në kontest juridiko-civil

Gjykata konform nenit 458 e 463 të KPPRK-se vendosi që të udhëzoi të dëmtuarën në kontest civil, për shkak të gjendjes së dobët ekonomike të të pandehurës.

9.Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurës, gjyqtarja e vetme gjykuese, duke u bazuar nën 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyroj që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.4571/17

Më 22.05.2018

**Zyrtarja ligjore,
Edona Grajçevci**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Fatime Dërmaku**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.